



**Ndërmarrja Publike Qendrore  
Posta e Kosovës Sh.A.**

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Drejtorëve me rregullore për marrjen dhe dhënien me qira të objekteve të PK Sh.A. Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar të hyra duke ofruar me qira hapësirat e lira nëpër objekte. Bazuar në rregulloret e brendshme dhe Ligjet në fuqi Posta së Kosovës Sh A., nxjerr këtë:

***Ofertë për Hapsirë me qera - Lakrishtë***

**KUSHTET DHE KRITERET E PK SH.A. PËR LËSHIMIN E HAPSIRAVE ME QERA**

- Hapësira/parcela kadastrale e cila ofertohet për qiradhënie gjendet brenda tërësisë urbane të Bllokut A, lagjja Lakrishtë sipas Planit Rregullues të Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimitarisë së Komunës së Prishtinës.
- Hapësira që do të lëshohet me qira, do ti dorëzohet qiramarrësit sipas gjendjes ekzistuese me mundësi të shfrytëzimit për parkingje apo forma tjera pa mundësi ndërtimi (objekte të forta).
- Qiramarrësi në pajtim me qiradhënësin,do ta këtë të drejtën që në hapësirën e marrë me qira të bëjë përmirësime, meremetime dhe adaptime shtesë, investime të cilat do të mbulohen nga vetë qiramarrësi.
- Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës, ujit dhe shërbimeve të tjera komunale do të paguhen nga qiramarrësi konform përpjesëtimit të shfrytëzimit të objektit hapësirës/parcelës kadastrale apo nëse ofrohen kushtet teknike të jenë të ndara në orëmatës të veçantë.
- Të gjithë të interesuarit do ta kenë mundësinë që paraprakisht ta vizitojnë hapësirën/parcelën kadastrale dhe ti verifikojnë sipërfaqet e hapësirave.

## Parcela / hapësira për qiradhënie

<b>Emërtimi i Parcelës</b>	<b>Tërësia urbane Blloku A,</b>		
<b>Adresa</b>	<b>Lagjia - Lakrishtë Prishtinë</b>		
	<b>Sipërfaqja m<sup>2</sup></b>	<b>Çmimi</b>	
<b>Hapësira /Parcela</b>	2300.08	..... €	
<b>Kontakti</b>	038 543 779 / 038 221 841		

### Kriteret:

1. Afati kohor i kontratës i negociuar.
1. Një komision i themeluar nga PK Sh.A., do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave më të mira dhe më të favorshme.
2. Afatet dhe kushtet e pagesës do të jenë konform negociatave të zhvilluara.

### Dokumentet e nevojshme:

Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin,  
Numrin fiskal,  
Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur.

### Afati për dorëzimin e ofertave:

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është deri me datën **10.06.2017** në ora **14:00**

Vendi i dorëzimit, Arkiva e Postës së Kosovës Sh.A. Dardani Rr. 28 Nëntori nr. 4,10000 Prishtinë ose përmes postës në adresën e lartcekur.